



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 14.09.2016 Ref.: 846/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), mori:

## V E N D I M

- I. Përmirësohet vendimi i KSHC-së Ref.: 630/16, datë 15.07.2016 i Fakultetit të Arteve, të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
- II. Shprehja "specializim" e përdorur tek programet e studimit të cekura më poshtë zëvendësohet me shprehjen "modul":
  - Dizajn Skene dhe Kostumografi, MA, 60 ECTS;
  - Regji Teatri, MA, 60 ECTS,
  - Aktrim, MA, 60 ECTS
  - Dramaturgji, MA, 60 ECTS
  - Artet Aplikative, MA, 60 ECTS
- III. Përmirësohet thirrja shkencore për këto programe të studimit nga:
  - Bachelor i Muzikës, BA, në Bachelor i Muzikës, BMus;
  - Bachelor i Muzikës në Performim, BA, në Bachelor i Muzikës në Performim, BMus;
  - Master i Muzikës, MA, në Master i Muzikës, MMus;
  - Master i Muzikës në Performim, MA, në Master i Muzikës në Performim, MMus.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së me Ref.: 630/16, datë 15.07.2016 mbetet e pa ndryshuar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Fakulteti i Arteve i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka parashtruar kërkesë me nr 427/16, dt. 27.07.2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA), për përmirësim të vendimit të KSHC-së me Ref.: 630/16, datë 15.07.2016.

Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, dhe kontrollimit të aplikacionit të Fakultetit të Arteve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë